



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-364
Datë: 02.05.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe Validohet IAAP Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "Austrian Schule" Rr. Gjilanit, kilometri III, Hajvali, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2025 deri 31.08.2028, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):
 - 1.1. Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e mësimit njëzetepesë (25) nxënës me një klase, brenda vitit shkollor mund ti regjistroj deri në 2 klase brenda vitit shkollor.
 - 1.2. Teknik Dentar, Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor deri me njëzetepesë (25) nxënës në një klase, brenda vitit shkollor.
2. Institucioni obligohet të plotësojë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimi të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- IAAP, Sh.M.L.M "Austrian Schule";
- Arkivit të AKK.

